

VENDIM
Nr. 770, datë 20.12.2017

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT
“MASTERPLANI 2016–2030 I UNIVERSITETIT BUJQËSOR TË TIRANËS”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 130/2016, “Për buxhetin e vitit 2017”, të ndryshuar, dhe të neneve 5, pikat 1, 20 dhe 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Masterplani 2016–2030 i Universitetit Bujqësor të Tiranës”.
 2. Shpronësimi të bëhet në favor të Universitetit Bujqësor të Tiranës.
 3. Pronarët, që shpronësohen për interes publik, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, me një vlerë të përgjithshme prej 89 527 462 (tetëdhjetë e nëntë milion e pesëqind e njëzet e shtatë mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e dy) lekësh.
 4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 89 527 462 (tetëdhjetë e nëntë milion e pesëqind e njëzet e shtatë mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e dy) lekësh, të përballohet nga buxheti i vitit 2017, miratuar për Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, në masën prej 75 000 000 (shtatëdhjetë e pesë milion) lekësh, dhe nga të ardhurat e Universitetit Bujqësor të Tiranës, në masën prej 14 527 462 (katërmbydhjetë milion e pesëqind e njëzet e shtatë mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e dy) lekësh.
 5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i vitit 2017, miratuar për Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.
 6. Shpronësimi të fillojë menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare.
 7. Pronarët e listës, që i bashkëlidhet këtij vendimi, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Universitetit Bujqësor të Tiranës.
 8. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë, brenda 30 ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Universitetin Bujqësor të Tiranës, të fillojnë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën treguese të regjistrimit, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe të bëjnë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të shtetit.
 9. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë, të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara, deri në momentin që të realizohet procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën treguese të regjistrimit, si dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.
 10. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë dhe Universiteti Bujqësor i Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Senida Mesi

LISTA E PASURIVE PRIVATE

QË SHPRONËSOHEN PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTTT “MASTERPLANI 2016-2030 I UNIVERSITETIT BUJQËSOR TË TIRANËS”

Tirane më 24.11.2017

Nr.	ZK	Nr. Pasurisë	Adresa	Pronari	Sipërfaqe Truallit	Sipërfaqe Ndërtimi	Çmimi i Truallit Lekë/m²	Çmimi i Ndërtimit Lekë/m²	Vlera e Truallit Lekë	Vlera e Ndërtimit Lekë	Vlera e ndërtimit sh.m,z me normen e amortizimit (4%)	Vlera e Truall dhe Ndërtësë	Shënime
1	8320	1/174	Koder Kamez TIRANE	Hazbi Roshi	46.0	26.0	22,985		1,057,310	1,805,551	1,733,329	2,790,639	Konfirmuar nga ZVRPP-ja : Lokal Hamburger - ndërtesa sipas situacionit te ndërtimit
2	8320	1/615-ND	Koder Kamez TIRANE	Hektor Kamberaj	277.7	277.7	22,985		0	12,652,486		12,652,486	Konfirmuar nga ZVRPP-ja : Godine e Kombinuar 2 Kate + 1 Kat Nentokesor. a - Sip. K. Nentoke <u>202.3 m2 Banim.</u> b - Sip. K. Perdhe 277.7 m2 Aktivitet c - Sip. K. Pare 174.4 m2 Aktivitet Shuma Totale <u>452.1 m2 Aktivitet</u>
3	8320	1/481	Koder Kamez TIRANE	Viviana Toptani Refik Toptani Ibrahim Toptani Evelina Toptani	2,841.0	259.0	22,985		65,300,385	8,783,952		74,084,337	Konfirmuar nga ZVRPP-ja, VILE + TRUALL (AKTIVITET)
VLERA TOTALE E SHPRONESIMIT												89,527,462	

V.O: Çmimet e truallit janë marrë nga VKM Nr. 89, datë 03.02.2016 (fq. 181)

P.S: Vleresimi perfundimtar eshte bere pas shqyrtimit te pretendimeve dhe ankesave te paraqitura nga subjektet e interesuara.